

URDHËRESË ADMINISTRATIVE 1999/2

UNMIK/DIR/1999/2

19 shtator 1999

PËR ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 1999/4, DATË 2 SHTATOR 1999 PËR PËRDORIMIN E VALUTËS SË LEJUAR NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autoritetin që i është dhënë me Rregulloren nr.1999/4 të UNMIK-ut për përdorimin e valutës së lejuar në Kosovë të datës 1 shtator 1999,

Nxjerr këtë urdhëresë administrative:

Neni 1

BUXHETI, REGJISTRIMET FINANCIARE DHE LLOGARITË

Në përputhje me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/4 buxhetet, regjistrimet financiare dhe llogaritë e organeve, të agjencive ose të institucioneve publike dhe të UNMIK-ut mbahen në marka gjermane (DM).

Neni 2

PAGESAT E DETYRUESHME DHE TARIFAT ADMINISTRATIVE

2.1 Në përputhje me paragrafin 4.1 të Rregullores nr. 1999/4, valuta e caktuar për t'u përdorur për pagesat e detyrueshme është marka gjermane.

2.2 Në përputhje me paragrafin 4.2 të Rregullores nr. 1999/4, tarifa administrative për një person që dëshiron të bëjë pagesa të detyrueshme në dinarë është 10 për qind e vlerës së pagesës së detyrueshme.

2.3 Tarifa administrative dhe pagesa e detyrueshme, nëse paguhen në dinarë, llogaritet sipas kursit më të ri të këmbimit të caktuar nga UNMIK-u.

Neni 3

HYRJA NË FUQI

Kjo direktivë administrative hyn në fuqi më 19 shtator 1999.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm